



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 1072
Dt. Rregj. 06.03.2015

Nr. Vendimi 812
Dt. Vendimi 15.10.2015

V E N D I M
"Mbi pushimin e gjykimit"

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Shkoder, e perbere nga:

Valbona Durraj – Gjyqtare

asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me 15.10.2015, ora 11.00 mori në shqyrtim në seancë përgatitore çështjen administrative me nr.Rregj.Them.1072 datë 06.03.2015 që l'përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: "Calzaturificio Adelchi", sh.p.k, me administrator Fehmi Golemi, me adrese Zona Industriale Shkoder. Cel: 0672017850, cel: 0682350270,përfaqshuar në gjykim nga z.Fatos Pelinku.

TE PADITUR: 1.Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder, e perfaqshuar nga drejtori i saj(në mungesë).
2.Drejtoria e Pergjithshme (Drejtoria e Apelimit) Tirane(në mungesë).

Me pjesmarrit: Avokaturës së Shtetit (në mungesë).

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ Nr.8052/1 date 06.10.2014 "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder dhe te atij me Nr. 29155/1 Prot. date 5.2.2015 te Drejtorise se Apelimit Tirane.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R.SH", i ndryshuar neni 114. Udhezmi Nr. 24, date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore ne R.SH", kreu XIII Ankimi adminisrativ tatimor pika 73.1. Ligji Nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeneve administrative" Nenet 3, 11 pika 1, 15 pika "a", 16 pika 1 dhe 18.

Gjykata pasi dëgjoi përfaqshuesin e palës paditëse z.Fatos Pelinku që kërkon pushimin e çështjes, në mungesë të palëve të paditura, shqyrtoi kërkesën dhe

VEREN se

Pala paditëse "Calzaturificio Adelchi", sh.p.k. është drejtuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me kërkesë padi me objekt:

Shfuqizimin e aktit administrativ Nr.8052/1 date 06.10.2014 "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder dhe te atij me Nr. 29155/1 Prot. date 5.2.2015 te Drejtorise se Apelimit Tirane.

Ne seancën përgatitore te dates 15.10.2015, nga ana e përfaqësuesit të palës paditëse, ekonomistit të firmës u kërkua pushimi i gjykimit të çështjes .

Ne nenin 39 pika 3 të ligjit 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", parashikohet se gjykata vendos pushimin e gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë.

Gjithashtu ne nenin 201, paragrafi i pare i K.Pr.Civile, parashikohet se:

"Paditesi ne çdo faze te gjykimit mund te heqe dore nga gjykimi i padise". Ne kete rast gjykata vendos pushimin e gjykimit."Edhe ne nenin 299, germa "b" te K.Pr.Civile, eshte parashikuar si nje nga rastet e pushimit te gjykimit kur paditesi heq dore nga gjykimi i çështjes.

Nisur nga sa sanksionohet ne keto nene dhe nga sa rezultoi ne gjykim, duke qene se kerkuesit kanë paraqitur kërkesë për pushimin e gjykimit, gjykata çmon se çështja duhet pushuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 39/3 të Ligjit 49/2012

VENDOSI

Pushimin e gjykimit të çështjes së ngritur nga pala paditëse "Calzaturificio Adelchi", sh.p.k

Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankim i vecantë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Për palët e paditura Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Pergjithshme Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkoder dhe Avokaturën e Shtetit (në mungesë),ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

Shkodër me datë 15.10.2015

SEKRETARE SEANCE

Borana LITI



GJYQTARE

Valbona DURRAJ



VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË 29.12.2015



KANCELARE

BLERTA NURJA

